




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Nr. 97/22

Drejtoria Komunale për Arsim



Mbështetur në nenin 62 pika 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, qershor 2008), nenit 47 pika c). Të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr. 98 datë: 30.07.2012, nenit 2, 3 dhe i Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës nr. 83 e datës 14.06.2013, dhe në mbështetje të vendimit me numër 140 të datës 14.03.2022 aprovuar nga Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë 14.03.2022 shpall:

Thirrje Publike për aplikim

PËR NDARJEN E NDIHMËS MOMENTALE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS DHE NDIHMËS MOMENTALE PËR FEMIJË ME NEVOJA TË VECANTA TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS

I. Komuna e Fushë Kosovës ndanë ndihme momentale për studentët e Komunës së Fushë Kosovës për vitin akademik 2021/22 në të gjitha fushat e studimit.

II. Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët/nxënësit që janë banorë të Komunës së Fushë Kosovës pa kurrfarë dallime etnike, gjinore, fetare dhe politike.

III. Kategoritë e përfituesve janë :

1. Studentet bachelor, master dhe doktoraturë (përparësi kane studentet me dege deficitare : teknike , shkenca natyrore matematikore , mjekësi , arkitekture etj.)
2. Studentet për studime jashtë vendit;
3. Studentet për vizita studimore jashtë vendit ;
4. Femijet me nevoja të veçanta ;
5. Femijet me aftësi të jashtëzakonshme , dhunti dhe talente të veçanta;

IV. Kriteret e përgjithshme për ndarjen e ndihmës momentale janë:

1. Të ketë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet ndihma momentale;
2. Nota mesatare e studimeve 7.0 e më lart;
3. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës dëshmi letërnjoftimi ose (dëshmi 3 vitet e fundit tatimi në pronë);
4. Të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomike-sociale të familjes;

5. Për studentet që shkojnë për studime jashtë vendit dëshmitë nga universiteti që është duke studiuar ;
6. Për vizita studimore jashtë vendit dëshmitë ku do të bëhet vizita studimore;
7. Për fëmijë me nevojë të veçantë, Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që dëshmon aftësinë e kufizuar;
8. Fëmijët me aftësi të jashtëzakonshme ,dhunti dhe talente të veçantë dëshmitë sipas UA nr.14/2019 nga MASHT.

V. Dokumentet e domosdoshme për aplikim :

1. Aplikacioni sipas formës së komunës (e gjeni të publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushe Kosovës);
2. Kopja e ID-së së studentit;
3. Vërtetimi se studenti ka të regjistruar vitin akademik 2021/22 (origjinale);
4. Certifikata e notave (origjinale);
5. Kopja e letërnjoftimit;
6. Deklarata e bashkësisë familjare (për studentet që janë 2 e më tepër nga një familje);
7. Konfirmimi i xhirrolllogarisë bankare.

Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti do të konsiderohet se nuk është banor i Komunës së Fushë Kosovës .

Për studentet me nevojë të veçantë:

Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që dëshmon nevojën e veçantë;

VI. Kriteret e përfitimit për nxënës me nevojë të veçantë :

1. Të jetë banor i Komunës së Fushe Kosovës dëshmi letërnjoftimi ose (dëshmi 3 vitet e fundit të jetës në prapësi);
2. Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i Komunës së Fushë Kosovës;
3. Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që dëshmon nevojën e veçantë;

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

-Formulari për aplikim (e gjeni të publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushe Kosovës);

- Certifikata/ekstrakti i lindjes se fëmijës ;
- Letërnjoftimi i prindit ;
- Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale qe dëshmon aftësinë e kufizuar.
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

Vërejtje : Dokumentet e pakompletuara dhe ato te dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do te shqyrtohen.

Thirrja mbetet i hapur 15 dite pune nga dita e publikimit ne tabelën e shpalljeve ne faqen zyrtare te Komunës se Fushë Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/category/shpalljet/konkurset/>

Konkursi mbetet i hapur nga data 14.03.2022 deri me date 01.04.2022.

